VENDIM
Nr. 225, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES PËR NJË HUA SHTESË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 47/2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për një hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit të rehabilitimi të rrugës së lumit të Vlorës, ratifikuar me ligjin nr. 47/2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

14 mars 2022 7:35 Marrë me 10/02/2021 23:54

(stema) **FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB**

(stema)

Ref: KF/ 11/1027/3	- 53	Faqet në total: 3
Data: 14.3.2022		CF: AB/79/Py
Faks: (965) 22999190 (965) 22999091	Telefon (965) 22999000 E-mail: operations@kuwait-fund.org	Faqja e internetit: http://www.kuwait-fund.org

Drejtuar: **Nr. i faksit/Email**

Shkëlqesisë së Tij Ministrit të Financave +355 4 2228 494
Ministria e Financave info@financa.gov.al
Tiranë-Republika e Shqipërisë

Kopja i dërgohet:
1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit +355 4 2234 885
Tiranë-Republika e Shqipërisë adf@albaniandf.org

2. Shkëlqesisë së Tij Ambasadorit të shtetit të Kuvajtit 00355
422 36501
Ambasada e Shtetit të Kuvajtit kuwaitembassy.tirana@gmail.com
Tiranë-Republika e Shqipërisë kuwaitembassy.tirana@mail.mofa.gov.kw

3. Shkëlqesisë së Tij Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë,
25240628
Ambasada e Republikës së Shqipërisë embassy.kuwait@mfa.gov.al
Kuvajt

Lënda: Programi i Rishikuar i Amortizimit të Marrëveshjes Shtesë të Huasë-Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës- K.F .Huaja Nr. 943/1027

Shkëlqësia Juaj,

Në referencë të shkresës sonë Nr. KF/11/1027/3-45, datë 22/02/2022, në të cilën kemi korrigjuar gabimin tipografik në datat gjashtëmujore të versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë për objektin.

Dëshirojmë të sjellim në vëmendje të Shkëlqesisë Suaj faktin se jemi në pritje të një kopjeje të Formularit të Konfirmimit që i përket ndryshimit të lartpërmendur që duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar dhe që duhet të na dërgohet neve (kopja bashkëlidhur).

Gjithashtu, ju lutem gjeni bashkëlidhur këtij dokumenti Programin e Rishikuar të Amortizimit, pas ndryshimeve në datat e Versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë për Objektin.

Duke i konfirmuar Shkëlqesisë Suaj bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni vlerësimin dhe konsideratën time më të lartë.

(Nënshkrimi)
Drejtor i Përgjithshëm
Marwan A. Th. AlGhanem

13030 2921 Faks: (965) 22999090/22999091 Tel: (965) 22990000
Kutia Postare: 2921 Salat, 12030 Kuvait – E-mail: info@kuwait-fund.org

14 mars 2022 7:35 Marrë me 10/02/2021 23:54

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

PROGRAMI I NDRYSHUAR I AMORTIZIMIT PËR HUATË E FONDIT TË KUVAJTIT NR. 943/1027 PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS - REPUBLIKA E SHQIPËRISË. **1027/943**

Kësti për tu paguar në K.D.	Data e Përfundimit	Kësti Nr.
495,000/-	01/11/2023	1
495,000/-	01/05/2024	2
496,000/“	01/11/2024	3
495,000/-	01/05/2025	4
495,000/-	01/11/2025	5
495,000/-	01/05/2026	6
495,000/-	01/11/2026	7
495,000/-	01/05/2027	8
495,000/-	01/11/2027	9
495,000/-	01/05/2028	10
495,000/-	01/11/2028	11
495,000/-	01/05/2029	12
495,000/-	01/11/2029	13
495,000/-	01/05/2030	14
495,000/-	01/11/2030	15
495,000/-	01/06/2031	16
495,000/-	01/11/2031	17
495,000/-	01/06/2032	18
495,000/-	01/11/2032	19
495,000/-	01/05/2033	20
495,000/-	01/11/2033	21
495,000/-	01/05/2034	22
495,000/-	01/11/2034	23
495,000/-	01/05/2035	24
495,000/-	01/11/2035	25
495,000/-	01/05/2036	26
495,000/-	01/11/2036	27
495,000/-	01/05/2037	28
495,000/-	01/11/2037	29
495,000/-	01/05/2038	30
495,000/-	01/11/2038	31
496,000/-	01/05/2039	32
495,000/-	01/11/2039	33
495,000/-	01/05/2040	34
495,000/-	01/11/2040	35
495,000/-	01/05/2041	36
495,000/-	01/11/2041	37
485,000/-	01/05/2042	38
Totali: 18,800,000/-		

(Vetëm tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind dinarë të Kuvajtit)

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

FORMULARI I KONFIRMIMIT

Me anë të kësaj konfirmojmë pranimin e gabimit me shkrim, të përcaktuar në këtë shkresë në lidhje me datën
e shlyerjes, d.m.th datën 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti të përcaktuar në Seksionin 2.08 të Marrëveshjes Shtesë të Huasë për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës, të ndryshuar më 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti.

Data:

Nga: Delina Ibrahimaj
(Përfaqësuesi i autorizuar)

الصندوق الكويتي للتنمية الاقتصادية العربية

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/ 11/1027/3 - 45		Numri total i faqeve: 2
Data: 22/2/2022	**Administrimi dhe Operacionet**	CF: AB/29/Py
Faks: (965) 22999190 (965) 22999090	Numri i telefonit (965) 22999000 **Email: operations@kuwait-fund.org**	Faqja e internetit: http://www.kuwait-fund/org

Drejtuar:
Shkëlqesisë së Tij, Ministrit të Financave
Ministria e Financave
Tiranë – Republika e Shqipërisë

Nr. i faksit/Email-i:
+355 4 2228 494
info@financa.gov.al

Për dijeni të:

1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit
   Tiranë – Republika e Shqipërisë
   +355 4 2234 885
   adf@albaniandf.org
2. Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Shtetit të Kuvajtit
   Ambasada e Shtetit të Kuvajtit
   Tiranë – Republika e Shqipërisë
   00355 422 36501
   kuwaitembassy.tirana@gmail.com
   kuwaitembassy.tirana@mail.mofa.gov.kw
3. Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë,
   Ambasada e Republikës së Shqipërisë
   Kuvajt
   25240628
   embassy.kuwait@mfa.gov.al

Lënda: **Korrigjim tipografik: Në lidhje me Seksionin 2.08 të Marrëveshjes së Huasë Shtesë – Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës**

Shkëlqesia Juaj,

Duke iu referuar Marrëveshjes së Huasë Shtesë në lidhje me Projektin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab në datën 02.03.2020, dëshirojmë të informojmë Shkëlqesinë Tuaj se për shkak të një gabimi tipografik, datat janë parashikuar në Seksionin 2.08 të versionit të Marrëveshjes së Huasë në gjuhën angleze si çdo gjashtëmujor më datë 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti në vend të datës 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti. Ne e kemi korrigjuar gabimin në versionin tonë të Marrëveshjes së Huasë në gjuhën angleze; për rrjedhojë, do ta vlerësonim nëse do të kryenit të njëjtin korrigjim në versionin tuaj, në mënyrë që datat të jenë data 1 maj dhe 1 nëntor e çdo viti, ndërsa këto data mbeten të pandryshuara në versionin e Marrëveshjes së Huasë në gjuhën arabe.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur Formularin e Konfirmimit në lidhje me ndryshimin e sipërpërmendur. Ju lutem merrni masat e nevojshme që ky dokument të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të na dërgohet sërish neve.

Duke siguruar Shkëlqesinë Tuaj për bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni vlerësimin dhe konsideratën time më të lartë.

(Nënshkruar)
Marwan A. Th. AlGhanem
Drejtor i Përgjithshëm

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

FORMULARI I KONFIRMIMIT

Nëpërmjet këtij dokumenti konfirmojmë pranimin e korrigjimit tipografik të parashikuar në këtë shkresë në lidhje me datën e shlyerjes së pagesës të parashikuar në Seksionin 2.08 të Marrëveshjes së Huasë Shtesë - Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës.

Data:

Nga: Delina Ibrahimaj
(Përfaqësuesi i Autorizuar)